

Përmallimet dhe diktatura e re

[Gazeta Shqiptare, 28.3.2006]

Përmallimet e shfrenuara për diktaturën enveriste, që kanë përmbytur mediat, duket sikur synojnë pranimin e një diktature të re, të asaj “antikorrupsion”.

Le të krahasojmë dy ngjarjet në vijim, që janë të së njëjtës kohë.

Ngjarja e parë: Dy analistë shqiptarë, njëri nga Tirana, e tjetri nga Prishtina, me të buzëqeshura babaxhançe, na dhanë lajmin se do të hapin, secili në secilin nga të dy kryeqytetet shqiptare, nga një lokal me emrin Enver Hoxha. Përmalloheshin pikërisht për atë që u bëri gjëmën shqiptarëve, për atë që po shqiptarët e fillimit të viteve '90 e thirrnin Enver-Hitler. Ky përmallim për enverizmin, nuk është thjeshtë një snobizëm pervers, por një shfaqje e një fenomeni shumë të rrezikshëm. Jo rastësisht ata analistët janë dy të konvertuar (convertiti), mbrojtës të praktikave antiligjore “antikorrupsion” të kryeministrit aktual të Shqipërisë.

Ngjarja e dytë: I kërkuam një miku në Gjermani, të na blinte një kopje të librit të Hitlerit, Mein Kampf (Lufta ime). Ku nuk kërkoi i gjori, por kudo mori të njëjtën përgjigje: “Nuk lejohet shitja e atij libri, sepse është propagandë naziste; mund t’a gjeni vetëm si libër me komente kritike për Hitlerin”. Nuk i besuam, dhe e bëmë telef internetin, por nuk gjetëm asgjëkundi një shitës, brenda Gjermanisë, të atij libri; kishte vetëm në vende të tjera, por jo në vendin e Hitlerit.

Hitleri dhe Enveri, nuk ndryshojnë në të këqiat që i kanë bërë popujve të vet. Ata që ndryshojnë, janë dy popujt. Gjermanët, janë popull që mëson nga historia e vet, dhe merr masa që një murtajë që ka kaluar një herë, të mos përsëritet më. Ne shqiptarët nuk kemi aftësinë të mësojmë nga historia, ne e harrojmë murtajen e kaluar, dhe si rezultat mund të na kthehet disa herë e njëjta e keqe; ky është një cen kombëtar yni.

Harresën historike e kemi manifestuar jo një herë, ku më e fundit ishte në zgjedhjet e “3 korrik 2005”: riciklimi i figurave që “i vunë zjarrin” Shqipërisë në '97-tën. Baza dokrinale e harresës përmbledhet në shprehjen pikëlluese: “Karta e 97-tës nuk ecën”.

Si t’ia bëjmë, se Shqipërinë nuk ka kush e bën tjetër përveç nesh, me gjithë cenet tona. E vetmja shpresë mbetet që të bëjmë veprime kolektive të tilla, që të shumëzohen anët e mira tonat, dhe të zbehen te metat. Veprimi kolektiv duhet të jetë projektuar i tillë që të dalë më i mirë se mesatarja e veprimit të secilit individ shqiptar veç e veç. Ky lloj projektimi, praktikisht nuk bëhet dot nga ne vetë, nga shqiptarët e fillimit të shekullit të XXI-të: na duhet të caktojmë dikë tjetër të projektojë për ne. Në fakt duket se tashmë e kemi bërë zgjedhjen: projektuesi ynë është SHBA dhe Bashkimi Evropian, pra perëndimorët..

Këshillat dhe detyrat e shtëpisë, ato antidiktaturë, që na japin perëndimorët, duhet të kthehen në ligje e vendime që kufizojnë ndonjë liri të individit, që të parandalohet humbja e të gjitha lirive. Konkretisht, duhet kufizuar liria, jo vetëm për të vrarë, për të vjedhur e për të përdhunuar, por edhe për të bërë një “lokal me emrin Enver Hoxha”, apo për të bërë riciklime të figurave përgjegjëse për rrënimet e Shqipërisë—përse, më liberalë se gjermanët, e shumë të tjerë, qenkemi ne shqipot!

Perëndimi po na këshillon dënimin e krimeve të komunizmit në të gjithë Evropën. Ia vlen të bëhemi pjesë edhe ne, duke bërë ligje që kufizojnë propagandën enveriste me foto, me libra, me

filma, me kujtime e me “lloqe analistësh” që na i përshkruajnë enveristët si engjëj të vërtetë. Ky kufizim, efektin kryesor do ta kishte jo në paranadalimin e enverizmit—kjo do të ishte luftë me mullijtë e erës—por në ngulitjen në mentalitetin shqiptar të parandalimit të çdo tipi diktature, qoftë edhe të asaj “antikorrupsion”, që po jep shënja të qarta të afrimit të saj.

Bashkim Kopliku

Durrës, më 27.3.2006